



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM

Nr. 575, datë 09.09.2025

PËR

**NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TË Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 503, datë 21.11.2022, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Ngritjen në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të z. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 11.09.2025.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkodër dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR